

INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Raporti Vjetor IADK 2012



Adresa:
Rr. Ulqini Nr. 74.
40000 Mitrovicë
Kosovë

www.iadk.org
info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726

Hyrje

Viti 2012 për IADK-në ka qenë një vite i suksesshëm në të gjitha drejtimet. IADK ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me fermerët e Kosovës dhe shoqatat e tyre, organizatat tjera joqeveritare, komunat dhe autoritetet qeveritare, duke i kushtuar rëndësi diversitetit dhe gjithëpërfshirës në aktivitetet e saj.

IADK synon të adresojë problemet e sektorit të bujqësisë duke përmirësuar cilësinë dhe sasinë e prodhimit bujqësor, rritjen e njohurive dhe konkurrencës të fermerët, fuqizimin e rolit të fermerëve në politikbërje, dhe fuqizimin e grave rurale. Kjo do të arrihet, për shembull, duke edukuar dhe konsoliduar fermerët përmes rrjetëzimit dhe organizimit, promovimit të teknikave dhe teknologjive moderne bujqësore, zhvillimin e zinxhirëve të vlerës, dhe avokimit për përdorim racional të burimeve natyrore dhe ruajtje të ambientit.

Duke pasur parasysh ambientin e në ndryshim të shpejtë në Kosovë si dhe mundësitë dhe sfidat e reja të IADK-së, përgatitja e një strategjie të re 2012-2018 për IADK-në ka filluar në 2011 dhe është finalizuar në vitin 2012. Procesi ka qenë me pjesëmarrje, duke angazhuar grupet kryesore të hisedarëve, partnerëve dhe stafit të IADK-së. Meqenëse strategjia e re do të formojë shtyllën kurriore të punës së IADK-së për vitet e ardhshme, ajo është një instrument dinamik që do të rishikohet dhe do të rifreskohet për të akomoduar ndryshimet në ambientin institucional, ekonomik dhe atë fizik.

Implementimi i strategjisë së IADK-së do të bëhet përmes projekteve me objektiva të tyre, plane të veprimit dhe buxhete të cilat dizajnohen në përputhje me kornizën strategjike dhe kontribuojnë në arritjen e vizionit të IADK-së.

Misioni i IADK-së është promovimi i zhvillimit socio-ekonomik në zonat rurale, reduktimi i papunësisë dhe krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave për të kontribuar në reduktimin e migrimit në zonat urbane, dhe mbështetjen e fermerëve dhe aktiviteteve bujqësore, duke marrë parasysh barazinë gjinore, përfshirjen e minoriteteve, integrimin dhe përfshirjen e popullsisë së kthyer dhe ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e ambientit.

Vizioni i IADK-së është: *“Zhvillimi i bujqësisë moderne për ushqim të sigurt dhe të shëndoshë, përmirësimin e jetës në vendbanimet rurale dhe ambientit të qëndrueshëm në Kosovë”*.

IADK beson që me një bashkëpunim të ngushtë të ekipit profesional të IADK-së, fermerëve, komunave, MBPZHR si dhe partnerëve ndërkombëtar do të arrijmë të prodhojmë ushqim të cilësisë së lartë dhe të kontribuojmë në zvogëlimin e importit dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Zenel Bunjaku - Drejtor Ekzekutiv

Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org

Partneret që kanë mbështetur projektet e IADK gjatë vitit 2012

IADK ka krijuar tanimë ekspëriencë substanciale të punës me partnerë të jashtëm. Organizata është duke implementuar një projekt tre vjeçar (2012-2014) i financuar nga një konzorcium donatorësh **Finn Church Aid FCA** (nga Finland), **Evangelischer Entwicklungsdienst EED** (Gjermania) dhe **Church of Sweden CoS** (nga Suedia) lidhur me edukimin dhe organizimin e fermerëve, si dhe me prezantimin e aktiviteteve të reja bujqësore.

Për të forcuar qëndrueshmërinë e IADK-së, **EED** nga Gjermania ka përkrahur ndërtimin e Qendrës për Edukimin e Fermerëve që do të udhëhiqet nga IADK. Qendra pre Edukimin e Fermerëve është në ndërtim e sipër kjo qendër te krijoj hapësirë të mjaftueshme dhe kushte për opërimin e stafit të IADK-së dhe klientëve te saj.

Partner tjetër i rëndësishëm është **Bashkimi Evropian** që ka financuar dy projekte:

Projekt dyvjeçar 2010-2012 në ngritjen e sasisë dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore përmes promovimit të praktikave të avancuara të farmitut në blegtori, hortikulturë dhe përpunim frutash.

Projekti dyvjeçar 2012-2014 në fuqizimin e shoqërisë civile në polik bërje në sektorin e bujqësisë.

IADK ka krijuar ekspëriencë në implementimin e projekteve të financuara nga agjenci të tjera ndërkombëtare siç janë **USAID** në implementimin e dy projekteve në sektorin e hortikulturës në promovimin e praktikave të reja në molla dhe dredhëz në nivel të Kosovës sidhe me **Shoqatën e Fermerëve nga Normandia e Ultë të Francës (AFDI)** dhe me **Ekspërtët Seniorë nga Holanda (PUM)**

Shtrirja e aktiviteteve:

Komunat Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Drenas dhe Podujevë, ndërsa me disa aktivitete në tërë Kosovën.

Departamentet kryesore të IADK-së janë:

Hortikulture:

Pemët, ku përfshihen mollët, kumbullat, dredhëza, mjedra dhe manaferra

Përimet, ku përfshihen kultivimi i domates, specit, trangujt, sallatat, spinaqit dhe kultivimi i fidanëve të përimeve në serra.

Frutat pyjore dhe bimët mjekuese ku përfshihet grumbullimi dhe tharja e frutave malore dhe bimëve mjekuese si dhe kultivimin e tyre.

Blegtoria, Ku përfshihen gjedhet delet dhe dhit prodhimi dhe përpunimi i qumështit, ushqimi për kafshë, përmirësimi racor dhe mekanizmi bujqësor.

Organizimi i fermerëve, ku përfshihen organizimin e fermerëve në nivel lokal dhe nacional

Përpunimi i ushqimit shtëpiak, ku përfshihen përpunimi i qumështit, pemëve dhe përimeve, organizimi i grave në shoqata.

Brenda çdo departamenti ekipet tona synojnë që:

Fermerët të rrisin aftësitë konkurruese në treg

Te zvogëlojnë mbështetjen e materialeve të importuara në sektorin e bujqësisë

Te përmirësojnë mjedisin në të cilin veprojnë fermerët, duke ju krijuar infrastrukturë më të mirë prodhuese dhe përpunuese.

Në bashkëpunim me institucionet përkatëse të bëjnë harmonizimin e ligjeve të bujqësisë.

Përfituesit e programit për vitin 2012

202 Familje kanë përfituruar mbështetje direkt nga programet e IADK:

pajisje për ftohjen e qumështit, makina të silazhit të misrit, pako higjienike për përmirësimin e kualitetit të qumështit, sistem të mjeljes së lopëve dhe pajisje tjera për ferma, makina mjelëse, serra me sistem të ngrohjes, makina për mulqerim, inute për kultivimin e brokolit, inute për kultivimin e kornishonit, serra, inute për kultivimi i bimëve aromatike mjekësore, inute për kultivimi i mjedrës dhe manaferrës, stacionet meteorologjike, pajisje për përpunimin e ushqimit.

135 Fermerë, Zyrtarë komunal për bujqësi dhe staf i IADK-së,

kanë marrë pjesë në 21 vizita në: Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Kroaci, Serbi, Francë, Poloni, Belgjike dhe Hungari

- 2877** Fermerë (pjesëmarrës), kanë marrë pjesë në 356 sesione të trajnimeve
- 49** Sesione të trajnimeve në sektorin e Blegtorisë, 461 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 134** Sesione të trajnimeve në sektorin e Hortikulturës, 1225 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 90** Sesione të trajnimeve në sektorin e Përpunimit Shtëpiak, 213 pjesëmarrëse kanë marrë pjesë.
- 33** Sesione të trajnimeve janë mbajtur në Organizimin e fermerëve, ku kanë marrë pjesë 405 pjesëmarrës
- 50** Sesione të trajnimeve janë mbajtur në sektorin e Menaxhimit të Bizneseve, 573 pjesëmarrës kanë marrë pjesë.
- 3** Pjesëmarrja ne Panairë Regjionale te Bujqësisë - mbi 111 fermerë ekspozuan produktet e tyre
- 1** Ditë e Dredhëzës - 64 fermerë kanë marrë pjesë me produktet e tyre
- 10** Publikime praktike, 7 broshura (“Menaxhimi i fermave të lopëve qumështore”, “Kultivimi i përimeve në serra”, “Praktika mbi prodhimin intensiv të mollës”, “Sistemet e kultivimit të dredhëzës”, “Mënyrat e shumimit të dredhëzës” dhe “Prodhimtaria organike të bimët mjekësore dhe kultivimi i tyre”) dhe 4 fletëpalosje (“Prodhimtaria organike e bimëve mjekësore, aromatike dhe mëlmesave”, “Prodhimtaria organike bujqësore”, “Përdorimi i pesticideve në menaxhimin e integruar të dëmtuesve të molla dhe “Përdorimi i pesticideve në menaxhimin e integruar të dëmtuesve të dredhëza”).
- 9** Workshop, ku kanë marrë pjesë 348 pjesëmarrës
- 7** Dite fushore, ku kanë marrë pjesë 238 pjesëmarrës
- 2** Tryeza të rrumbullakëta, ku kanë marrë pjesë 78 pjesëmarrës
- 3** Partnerë ndërkombëtar, AFDI, PUM, FFRM

Stafi i IADK-së ka kontribuar nëpërmjet grupeve të ndryshme punuese në përgatitjen e strategjive, ligjeve, kriterëve etj., të cilat janë organizuar nga institucionet dhe organizatat lokale, regjionale dhe kombëtare.

Departamenti i Hortikulturës

Inkubatorët për mbirje të farave

Me qëllim të avancimit të prodhimit të fidanëve të përimeve dhe luleve IADK këtë vit ka përkrahur 5 fermerë që merren me prodhimin e fidanëve të përimeve me nga një inkubator/dhomë mbirëse të farave të përimeve, me vëllim prej 11 m³. Përfituesit janë zgjedhur në bashkëpunim me departamentet komunale për bujqësi dhe kryesisht janë përkrahur prodhuesit e fidanëve të përimeve të cilët kanë një përvojë të mirë me këtë prodhimtari porse ende nuk kanë arritur të aplikojnë teknikat më të avancuara të kësaj prodhimtarie, të cilat sigurojnë kualitet më të lartë të fidanëve, zvogëlojnë koston e prodhimit dhe sigurojnë prodhim më të lartë gjatë kultivimit të mëtejshëm. Përfituesit janë nga tri komuna: Vushtrri (2), Podujevë (2) dhe Drenas (1).

Inkubatorët përveç shfrytëzimit për mbirjen e farërave të përimeve e të luleve, ata gjatë vegjetacionit mund të shfrytëzohen edhe për ruajtjen apo para ftohjen e frutave të përimeve, dhe në saje të kësaj njëri nga përfituesit nga Drenasi, i cili kultivon përime dhe dredhëza në fushë të hapur dhe ambiente të mbyllura, inkubatorin e ka shfrytëzuar për para ftohje e ruajtje frutave. Ndërsa për shkak të furnizimit dhe montimit të inkubatorëve pas kalimit të sezonës së prodhimit të fidanëve, ata nuk janë shfrytëzuar këtë vit për mbirjen e farave dhe se përdorimi i tyre do të fillojë në vitin e ardhshëm.



Kultivimi i brokolit

Në kuadër të promovimit të kulturave të reja IADK, ka planifikuar mbështetjen e fermerëve me farëra dhe impute përcjellëse për kultivimin e brokolit. Paraprakisht janë bërë disa takime nëpër komuna me agronom në drejtoritë komunale për bujqësi, si dhe me disa fermerë që kanë filluar me kultivimin e sipërfaqeve të vogla me brokoli. Në bazë të këtyre takimeve janë marrë informacione për problemet që mundë të hasen në plasimin e kësaj kulture, për të

cilën kërkesat e tregut janë të vogla, porse në rritje. Edhe pse ishte planifikuar që secili përfitues të mbështet në kultivimin e sipërfaqeve me nga 20 ari me brokol, duke e parë se fermerët dyshonin për mundësitë e paraqitjes së problemeve me plasimin e prodhimeve të kësaj kulture, IADK ka vendosur që fermerët përfitues të mbjellin nga 10 ari me brokol dhe 10 me lulëlakër.

Janë përkrahur 10 fermer nga komunat: Podujevë (5), Drenas (3), Vushtrri (1) dhe Mitrovicë (1). Secili përfitues është furnizuar me një pako kompletë me impute për kultivimin e sipërfaqes prej 2000 m² me brokoli e lulëlakër, (farëra, module polisteroli, substrat steril për mbjelljen e farërave, rezervuar me kap.1000 litra, sistem të ujitjes pikë-pikë, foli të zezë për mulqirim, plehra minerale dhe kristalore, pompë spërkatëse 20 litërshe dhe një pako pesticidesh. Po ashtu fermerët përfitues kanë marrë edhe një doracak/udhëzues praktik për teknikën e kultivimit të brokollit e lulëlakrës, si dhe janë mbajtur trajnime këshilluese në teren gjatë vegetacionit.

Mbjelljet e para të farërave janë bërë në fund të prillit dhe kanë vazhduar në mënyrë succesive, ndërsa vjeljet e para të brokollit kanë filluar nga 10 korriku, dhe kanë përfunduar në fund të nëntorit. Gjatë vegetacionit përkatësisht në kohën e vjeljes është organizuar edhe një vizitë e përbashkët me përfitues në njërin nga fushat më të sukseshme me brokoli dhe lulëlakër të njëri nga përfituesit në Podujevë, me qëllim të shkëmbimit të përvojave si të kultivimit ashtu edhe të tregtimit të prodhimeve, kohës së vjeljes, ruajtjes e paketimit.

Nga 10 përfituesit është arritur një prodhim mesatar me brokoli e lulëlakër prej 2500 kg/20 ari, ndërsa prodhimi më i lartë ka shkuar në 5700 kg. Çmimi mesatar për kg ka qenë 0.82 € ndërsa mesatarja e të hyrave për fermerë 2050 €. Njëri nga përfituesit është vizituar edhe nga televizionet vendore dhe intervista e tij si kultivues i brokollit, është transmetuar në televizionin publik në një emision që trajton ushqimin e shëndetshëm.



Kultivimi i kornishonëve

Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org

Ndër projektet e parapara për përkrahje të minoriteteve në sektorin e përimitarisë janë mbështet 15 fermerë serbë me farëra dhe impute përcjellëse për kultivimin e kornishonëve në sipërfaqe me nga 1000 m². Përfituesit kanë qenë nga dy komuna: Vushtrri (14) dhe Mitrovicë (1). Të gjithë përfituesit kanë marrë nga një pako kompletë të imputeve për kultivimin e kornishonit në sipërfaqe me nga 1000 m² (farëra hibride të kornishonit, substrat steril për mbjellje të farërave, plehra minerale dhe kristalore, pompë spërkatës 20 litërshë, pako të pesticideve, rezervuar me kapacitet 1000 litrash, sistem të ujitjes pikë-pikë, tel të galvanizuar dhe rrjetë plastike për mbështetjen e bimëve në formë shpaliri. Krahas ofrimit të imputeve fermerëve u është shpërndarë edhe një udhëzues për teknikat e kultivimit të kornishonit, si dhe janë mbajtur trajnime dhe vizita këshilluese në terren gjatë vegjetacionit. Mbjellja e farërave ka filluar nga fundi i korrikut, ndërsa vjeljet e para në fund të gushtit dhe kanë përfunduar më 10 tetor, ku për shkak të temperaturave të ulëta bimët janë dëmtuar.

Mesatarja e të hyrave për përfitues janë 800 € kurse prodhimi mesatar për përfitues 1400 kg, ndërsa prodhimi më i lartë 2300 kg. Sa i përket plasimit të prodhimit fermerët nuk kanë pasur problem, ndërsa çmimi mesatar ka qenë 0.57 €/kg. Gjatë kohës së vjeljes është organizuar një vizitë me përfitues te një qendër grumbulluese e përimëve në Mamushë, si dhe te një pikë përpunuese/konservuese e përimëve në fshatin Dolak të Vushtrrisë. Qëllimi i kësaj vizite ishte lidhja e fermerëve prodhues me pikat e shitjes së produkteve të tyre, dhe në ndërkohë atyre u janë ofruar oferta të shitjes së përbashkët të kornishonëve.



Ndonëse janë realizuar prodhime jo të kënaqshme të kornishonëve si pasojë e problemeve të cekura më lartë, fermerët nga komuniteti serbë kanë vërejtur se përfitimet nga kjo kulturë mund të jenë shumë të favorshme, dhe janë motivuar për kultivimin e kornishonit edhe në vitet e ardhshme, duke pasur parasysh se disa nga imputet mundë të shfrytëzohen edhe në vitet tjera, si janë sistemi i ujitjes, rezervuarët e ujit, sistemi i lidhjes së bimëve, si dhe përvoja e fituar në teknikën e kultivimit.

Serra demonstruese në Çabër

Gjatë vitit 2012 kanë vazhduar trajnimet me dy grupe të fermerëve në serrën demonstruese në fshatin Çabër, e cila është ndërtuar një vit më parë, me sipërfaqe prej 500 m². Nga të dy grupet 30 fermerë kanë ndjekur 4 sesione trajnuese për praktikën e prodhimit të fidanëve dhe prodhimin e integruar të përimeve. Po ashtu fermerit përfitues i serrës, IADK i ka siguruar farëra hibride të përimeve dhe impute tjera të nevojshme për prodhimin e 12 mij fidanëve cilësorë të përimeve, me teknika më të avancuara. Fermerët që kanë ndjekur këto trajnime janë furnizuar me nga 400 fidanë cilësorë të prodhuara në kaseta polisteroli dhe substrat steril, duke paguar një çmim simbolik prej 0.15 € për fidanë apo 50 % më lirë se çmimi i tregut.



Përveç trajnimeve grupore secili fermerë në baza mujore është vizituar gjatë vegetacionit të përimeve duke i dhënë këshilla përkatëse sipas gjendjes së bimëve në serrë. Edhe përfituesi i serrës është monitoruar vazhdimisht nga stafi profesional i IADK-së dhe ka bashkëpunuar dhe aplikuar në tërësi rekomandimet dhe këshillat e ofruara. Gjatë këtij viti në serrë janë prodhuar 35000 fidanë të përimeve dhe shitur me një çmim mesatar prej 0.25 €fidanë, ndërsa pas shitjes së fidanëve serra është mbjell me domate me dendësi prej 3 bimë/m². Nga vegetacioni i bimëve të domates janë prodhuar 7140 kg domate dhe plasuar në tregun lokal të Mitrovicës me një çmim mesatar prej 0.45 €kg, si dhe 310 kg kornishon, e që janë shitur me një çmim prej 0.50 €kg. Në bazë të këtyre të dhënave shihet se fermeri ka realizuar të hyra të përgjithshme nga serra një vlerë prej 12,118.00 € duke mos llogaritur edhe spinaqin i cili është mbjellur në serrë në sezonën e vonë të vjeshtës dhe ende nuk ka arritur për vjelje.



Serra demonstruese në Pestovë

Duke parë interesimin dhe nevojën e fermerëve për të ndjekur praktikat më të avancuara të prodhimit të serra, e me qëllim të rritjes së prodhimeve cilësore të perimeve dhe shfrytëzimit më racional të ambienteve të mbrojtura, e në anën tjetër për të qenë më afër fermerëve kultivues të perimeve, IADK në qershor të këtij viti ka ngritur edhe një serrë demonstruese me sipërfaqe prej 500 m², e kompletuar edhe me sistem të ngrohjes dhe impute tjera përcjellëse, në fshatin Pestovë të komunës së Vushtrisë. Përfitues i kësaj serre Daut Kosumi është një fermerë me një përvojë bukur të madhe në kultivimin e perimeve në serra, por që nuk ka mundur ende të investojë në ndërtimin e serrave më të avancuara. Serra është përfunduar në gjysmën e qershorit dhe është mbjell me domate (1250 bimë) dhe tranguj (250 bimë). Gjatë vegetacionit janë prodhuar 3680 kg domate dhe 1400 kg tranguj, si dhe 150 kg spinaq, duke krijuar të hyra të përgjithshme në vlerë prej 2300 €. Në këtë serrë gjatë vitit janë mbajtur 10 sesione të trajnimeve praktike me një grup prej 15 fermerësh, duke përcjell të gjitha fazat e punëve gjatë kultivimit të perimeve në serrë.

Serra për prodhimtari organike të perimeve

Në përgjigje të kërkesave të reja të tregut për produkte të shëndetëshme me cilësi të lartë, e me qëllim të promovimit të prodhimit organik të perimeve, si dhe demonstrimit të praktikave të rritjes së bimëve me metodën biologjike/organike, IADK ka paraparë ngritjen e një serre model me sipërfaqe prej 500 m².

Përfitues i serrës është Sami Sylejmani nga komuna e Vushtrisë, ndërsa përzgjedhja e fermerit dhe e vendit për vendosjen e serrës është bërë në bashkëpunim me departamentin komunal të bujqësisë. Serra është montuar në fshatin Stanofcë të Ulët, por për shkak procedurave të tenderimit dhe ritenderimit, pastaj disa vonesave të pajisjeve të cilat punkryesi i serrës duhej importuar nga Greqia, dhe kushteve të pafavorshme klimatike nuk është përfunduar kompletimi (mbulimi) i serrës. Kompletimi i serrës dhe imputeve përcjellëse do të përfundojë gjatë muajit



shkurtë 2013, dhe do të shërbejë si qendër e demonstrimit praktik të prodhimit organikë të përimeve, për fermerë dhe grupe të fermerëve nga Kosova, të cilët në të ardhmen duan të kalojnë në këtë prodhimtari.

Makina për mulqirim

Për të lehtësuar punën e fermerëve dhe cilësinë e përgatitjes së tokës për mbjelljen e kulturave të ndryshme përimore dhe dredhëzave në fushë të hapur, IADK ka shpërndarë një makinë e cila tërhiqet me traktor dhe me një kalim bënë përgatitjen e shtratit të mbjelljes (lentës), vendosë gypat e ujitjes dhe folinë e zezë për mulqirim të tokës. Përfitues i makinës është njëri nga fermerët që është anëtarë i OJQ-së “Përimkultura” nga Vushtrria, i cili për anëtarët e kësaj shoqate dhe fermerët përfitues të IADK-së, do të punoi për 30% më lirë se çmimi i tregut. Gjatë vitit fermeri ka filluar promovimin e punës me këtë makinë duke përgatitur 0.60 ha të tokës për mbjellje të brokollit dhe të dredhëzave në Podujevë, Vushtrri e Skenderaj. Meqenëse ky vit ka qenë i përcjell me temperatura shumë të larta dhe thatësi të madhe të tokës, shfrytëzimi i makinës ka qenë paksa i kufizuar, ngase përdorimi i saj kërkon një strukturë të tokës mirë të përgatitur dhe shumë të shkrifët.



Kultivimi i bimëve aromatike mjekësore

Një komponent tjetër e re të cilën gjatë këtij viti e ka filluar IADK, është edhe përkrahja e fermerëve në kultivimin e bimëve aromatike mjekësore, të cilat janë shumë pakë të kultivuara në vendin tonë, ndonëse ekzistojnë kushte të favorshme klimatiko-tokësore për kultivim, e po ashtu edhe një treg thuajse i sigurt për plasimin e tyre. Së pari është inicuar me procedurat e kultivimit të Gentianës, kultivimi i së cilës kërkon një



përkujdesje të veçantë, sidomos gjatë prodhimit të fidanëve. Gjatë prodhimit të fidanëve farat e kësaj bime kërkojnë një trajtim të veçantë në lagështi dhe temperaturë të ulët prej 2°C për së paku 10 javë, ndërsa një vit është i nevojshëm për prodhimin e fidanëve nga mbjellja e farës deri në arritjen e fidanëve për mbjellje në fushë për kultivimin e tyre.

Për këtë arsye gjatë këtij viti përmes tenderit është zgjedhur kompania për prodhimin e fidanëve të gentianës, e cila ka mbjell farat duke aplikuar teknikat adekuate të kësaj prodhimit dhe se farat kanë kaluar fazën e mbirjes dhe deri në muajin maji 2013 do të jenë të gatshme për mbjellje dhe kultivimin e tyre në fushë, tek përfituesit të cilët do të përzgjidhen në vitin e ardhshëm.

Nga bimët tjera aromatike mjekësore të planifikuara për kultivim është edhe Mëllaga e Bardhë, për të cilën janë përzgjedhur tetë përfitues nga katër komuna: Vushtri-3, Drenas-2, Mitrovicë-1, Skenderaj-1 dhe Podujevë-1. Fermerët janë përzgjedhur në bashkëpunim me departamentet komunale për bujqësi, duke marrë parasysh fermerët të cilët kanë pasur edhe më heret pak a shumë përvoja në kultivimin apo mbledhjen e bimëve mjekësore, si dhe parcelat të cilat kërkohet të jenë sa më ekologjike, ngase këto bimë nuk duhet të trajtohen me plehra minerale.

8 përfituesit janë furnizuar me farëra të mëllagës së bardhë për mbjellje të sipërfaqeve me nga 0.20 ha, pastaj me rezervuar plastik me kapacitet prej 1000 litrash, sistem të ujitjes pikë-pikë, rrjetë të gjelbër për rrethojë të parcelës si dhe me nga një serrë me konstrukcion nga metali i zinkuar me sipërfaqe prej 50 m² për terjen e bimëve mjekësore (gjethëve, luleve, rrënjëve etj).

Paraprakisht me fermerët është organizuar edhe një trajnim fushorë për kultivimin e mëllagës së bardhë, nga një kultivues dhe grumbullues i njohur i bimëve mjekësore në Istog, i cili po ashtu është angazhuar edhe në mbjelljen me makinë të farërave të mëllagës dhe ofrimin e këshillave të secili përfitues. Edhe gjatë realizimit të këtij projekti fermerët janë përballur me vështirësi shumë të mëdha në përgatitjen e tokës për mbjellje për shkak të



thatësisë shumë të madhe të tokës dhe mungesës së reshjeve edhe në sezonën e vjeshtës, e që kanë shtyrë mbjelljen e farave deri në gjysmën e nëntorit.

Pemishtja demonstruese e mollës

Pemishtja intensive e ngritur me mollë në vitin e kaluar me sipërfaqe prej 1 ha, në fshatin Vaganicë të komunës së Mitrovicës, edhe këtë vit është monitoruar rregullisht nga stafi përgjegjës i IADK-së, ndërsa bimët kanë pas një zhvillim të mirë edhe gjatë vitit 2012, duke dhënë një rendiment të kënaqshëm prej 6 tonësh. Po ashtu pemishtja është shfrytëzuar edhe si qendër për demonstrimin praktik të teknikave të kultivimit intensiv të mollës për fermerët tjerë. Për menaxhim më të lehtë të sëmundjeve dhe dëmtuesve, fermerit i është siguruar edhe një atomizer për trajtimin e pemishtes me pesticide. Gjatë vitit janë mbajtur katër sesione të trajnimeve me dy grupe të fermerëve ku kanë marrë pjesë 30 fermerë, të cilët njohurit e fituara nga këto trajnime kanë filluar t'i aplikojnë në pemishtet e tyre.



Kultivimi i mjedrës dhe manaferrës

Në kultivimin e frutave të imëta janë përkrahur tetë fermerë të minoritetit serb të cilët vijnë nga dy komuna: Zubin Potok-4 dhe Vushtrri-3. Të gjithë përfituesit janë furnizuar me fidanë të mjedrës dhe manaferrës për kultivimin e sipërfaqeve me nga 1000 m² (gjysma mjedër dhe gjysma manaferrë), pastaj me plehra minerale dhe kristalor, pako të pesticideve, pompë spërkatëse me kapacitet 20 L, rezervuar plastik me vëllim 1000 L, sistem të ujitjes pikë-pikë, shtylla betoni dhe tel të galvanizuar për mbështetjen e bimëve dhe gërhshërë për krasitje. Përveç këtyre imputeve me përfituesit janë organizuar edhe trajnime dhe vizita në terren, me qëllim të ofrimit të njohurive profesionale për kultivimin e këtyre bimëve.




Përgatitja e tokës dhe mbjellja e fidanëve janë kryer gjatë muajit nëntor, ndërsa katër nga fermerët kanë vendosur edhe shtyllat për lidhjen e bimëve.

Stacionet meteorologjike

Duke parë problemet e shpeshta me të cilat fermerët ballafaqohen gjatë vegjetacionit të kulturave bujqësore, e sidomos në mbrojtjen e pemëve dhe përimeve nga sëmundjet dhe dëmtuesit, mungesa e informacioneve sinjalizuese për paraqitjen e sëmundjeve dhe kohës së përshtatshme për trajtimin e bimëve me pesticide, IADK ka ngritur dy stacione meteorologjike në dy lokacione të ndryshme të regjionit;



njëri stacion është vendosur në një pemishte me mollë në fshatin Vaganicë të Mitrovicës, që do të jep informacione për parametrat e ndryshëm klimatik të cilat do të shfrytëzohen në përcaktimin e momentit më të favorshëm për trajtimin e pemëve për mbrojtje nga sëmundjet dhe dëmtuesit, ndërsa stacioni tjetër është vendosur në fshatin Pestovë të Vushtrisë, ku për çdo vit kultivohen sipërfaqe të mëdha me patate, e që do të shërbejë për dhënien e informacioneve më të sakta për kohën e rrezikut të paraqitjes së infeksioneve të patates nga sëmundjet dhe momentin më të duhur të trajtimit të sëmundjeve. Nga kompania furnizuese janë ofruar edhe disa njohuri bazike rreth përdorimit dhe funksionimit të këtyre stacioneve dhe stafi përgjegjës i hortikulturës ka filluar me testimin e përdorimit të tyre dhe se në vitin 2013 do të jetë i gatshëm në shfrytëzimin e stacioneve meteorologjike dhe njoftimin e fermerëve për kohën më të përshtatshme të trajtimit të kulturave bujqësore.



Shërbimet këshillimore të fermerët për format e reja të kultivimit të mollës e dredhëzës dhe menaxhimi i integruar i dëmtuesve

Në kuadër të programeve të USAID-it përkatësisht projektit NOA (Mundësitë e Reja për Bujqësi), i cili këtë vit ka përkrahur 12 fermerë në kultivimin e dredhëzave dhe 6 fermerë në kultivimin intensiv të mollës, duke ofruar kultivar të rinj të këtyre dy kulturave, IADK ka qenë e kontraktuar për të ofruar te fermerët të gjitha shërbimet këshillimore që kanë të bëjnë me kultivimin intensiv të mollës dhe dredhëzës dhe aplikimin e menaxhimit të integruar të dëmtuesve. Fermerët e



përkrahur me këtë projekt kanë qenë nga komuna të ndryshme të Kosovës (Mitrovicë, Skenderaj, Lipjan, Pejë, Deçan, Gjilan, Kamenicë, Shtime, Suharekë, Rahovec), ndërsa IADK-ja përveç stafit profesional të kyçur në ofrimin e shërbimeve këshillimore te këta fermer, ka angazhuar edhe 4 student, të cilët kanë ndjekur rregullisht të gjitha teknikat e kultivimit intensiv të mollës dhe dredhëzës, dhe kanë avancuar me sukses njohuritë praktike në kultivimin e bimëve dhe menaxhimin e integruar të dëmtuesve.

Angazhimi i stafit të IADK-së ka qenë që nga identifikimi i parcelave, monitorimi i marrjes së mostrave për analiza të dheut duke dhënë rekomandimet e plehërimit në bazë të pjellorisë së tokës, përgatitjen e specifikacioneve për fidanë dhe impute përcjellëse, përgatitjen e planit të mbjelljes së bimëve për secilin fermerë, si dhe trajnimet dhe monitorimet e rregullta për të gjitha masat agroteknike të kultivimit të bimëve dhe menaxhimin e integruar të dëmtuesve, si dhe përgatitjen e librit për mbajtje të shënimeve në fermë.



Gjatë implementimit të projektit janë organizuar 7 ditë fushore, 2 work-

shope dhe janë mbajtur 89 trajnime për fermeret. Në kuader të projektit fermeret janë perkrahur edhe në pjesamrrije në panairë me qëllim të promovimit të produkteve të tyre.

DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

Model ferma e lopëve qumështore

Sektori i prodhimit të qumështit të lopëve në regjionin e Mitrovicës është duke u zhvilluar fale përkushtimit të fermerëve dhe përkrahjes nga donatorët e ndryshëm. Gjatë vitit 2012 IADK ka vazhduar me përkrahjen e këtij sektori dhe dhënien e këshillave dhe trajnimeve të fermerëve në model fermën e lopëve qumështore e cila është ndërtuar në fshatin Bukosh komuna e Vushtrrisë.



Gjatë këtij viti 51 fermerë nga regjioni i Mitrovicës janë trajnuar në 7 sesione të trajnimeve në aspektin profesional të blegtorisë dhe në menaxhimin e fermave. Te gjithë fermerët të cilët i kanë ndjekur trajnimet në funde janë certifikuar për pjesëmarrje të suksesshme në trajnime.

Gjatë këtij viti model ferma e lopëve qumështore është kompletuar edhe me ndërtimin e gropës septike, depon e ushqimit voluminoz dhe silosit për silazhin e misrit.

Rezultate e këtij aktiviteti janë: Model ferma e lopëve është ndërtuar dhe është funksionale me të gjitha anekset përcjellëse, ku kapaciteti prodhues i qumështit në ferme është 100,000.00 lit qumësht në vit, janë përgatitur kurikulat e trajnimeve (12 sesione) për sektorin e blegtorisë dhe 7 sesione për menaxhimin biznesor të fermës dhe 51 fermerë janë trajnuar në aspektin praktik lidhur me menaxhimin e fermave qumështore

Si rezultat i këtij aktiviteti, trajnimeve dhe këshillave, fermerët të cilët kanë qene të përfshirë në këtë projekt kanë përmirësuar menaxhimin e fermave dhe si rezultat kanë rritur të hyrat në fermat e tyre ku: 18.1 % është rrite numri i lopëve, 16.5 % është rrite prodhimtaria e qumështit dhe 27.0 % është përmirësuar kualiteti i qumështit

Ndërtimi i model fermës për dhi

Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org

Infrastruktura e dobët e fermave të dhive në vendin tone, menaxhimi jo i mirë i fermave dhe përvoja jo e mirë në këtë sektor janë një ndër faktorët që pengojnë zhvillimin e këtij sektori. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe zbatimit të praktikave të mira, IADK gjatë vitit 2012 ka bërë ndërtimin e model fermës për dhi me kapacitet prej 100 dhive sipas standardeve evropiane. Model ferma e dhive është ndërtuar në komunën e Mitrovicës dhe është duke shërbyer si qendër demonstruese për fermerët e regjionit të Mitrovicës dhe më gjerë.

Ndërtimi i model fermës është bërë sipas standardeve që kërkohen në mbarështimin e kafshëve dhe posedon dhomën mjelëse me kapacitet 12 dhi në një mjelje, me sistem automatik të mjeljes, dhomën për ruajtjen dhe ftohjen e qumështit me kapacitet 500 litër, ujë pirëset automatike, dhe pjesët tjera përcjellëse.

Me qëllim të implementimit të praktikave të mira në nivel më të gjerë, IADK ka themeluar tri grupe të fermerëve nga komunat e Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skenderajt. Me secilin fermer IADK ka nënshkruar kontrata ku IADK ka trajnuar 19 fermerë në 6 sesione të trajnimit në aspektin profesional të blegtorisë dhe në 5 tema në aspektin e menaxhimit të fermave.



Përmirësimi i kualitetit të qumështit

Për të përmirësuar kualitetin e qumështit, gjatë vitit 2010 IADK ka ndihmuar 88 fermerë nga komunat e Vushtrrisë, Skenderajt, Mitrovicës, Drenasit dhe Podujevës me pajisje higjienike. Secili fermer ka përfituar nga një pako higjienike e cila përmban: acid dhe bazë për pastrimin e pajisjeve mjelëse, dezinfektues të gjirit, jod, test për zbulimin e mastitisit (CMT), brushave për pastrimin e makinave mjelëse dhe bidon për transportimin e qumështit. Qëllimi i projektit ka qenë që fermerët të trajnohen në aplikimin e procedurave për prodhimin e qumështit kualitativ, duke përfshirë praktikat e mira të mjeljes, pastrimin adekuat të makinave mjelëse, ruajtjen dhe transportin e qumështit deri tek përpunuesi. IADK ka monitoruar dhe trajnuar fermerët gjatë gjithë vitit. Në bashkëpunim me grumbulluesit e mostrave të qumështit nga Agjencioni Veterinar i Kosovës,



mostrat e qumështit janë marrë në baza mujore dhe janë dërguar për analiza në laboratorin e qumështit të Agjencisë së Veterinarisë dhe Ushqimit në Prishtinë.

Rezultatet e këtij aktiviteti janë: 88 fermerë kane përfituar pajisje higjienike, 27.27 % e fermerëve kane kaluar ne ekstra klase dhe 88 fermerë janë trajnuar ne aspektin praktik ne përmirësimin e kualitetit te qumeshtit

Përgatitja e silazhes së misrit

Me qellim te uljes se kosatos se prodhimit dhe përmirësimit te bazës ushqimore për kafshe, IADK gjatë vitit 2012 ka përkrahur 7 fermerë me makina për korrjen e silazhit te misrit.

Përfituesit e makinave te silazhit janë nga komunat e Vushtrrisë, Skenderajt, Mitrovicës, Drenasit dhe Podujevës. Të gjithë përfituesit gjatë këtij viti i kanë përdorur makinat e silazhës ne mënyrë të duhur dhe kanë kryer shërbime edhe për 29 fermerë të tjerë. Numri i përgjithshëm i sipërfaqes së korrur me silazhe të misrit ka qenë 69 ha, ku çmimi mesatar për ha ka qenë prej 170 €/ha. Te hyrat e përgjithshme nga shfrytëzimi makinave te silazhit te misrit për të gjithë përfituesit janë rreth **11,730.00 €**



Pas shfrytëzimit të makinave të silazhit në mënyrë adekuate dhe në kohën e duhur dhe trajnimeve te fermerëve, fermerët kanë përmirësuar kualitetin e silazhës së misrit e cila ka rezultuar rritjen e prodhimit të qumështit.

Instalimi i pajisjeve ftohëse të qumështit (laktofriza) në fermë

Me qellim te përmirësimit te kushteve te fermës dhe përmirësimit te kualitetit te qumeshtit, IADK gjatë vitit 2012 ka përkrahur 8 fermerë me laktofriza dhe pajisje tjera për grumbullimin dhe ruajtjen e qumeshtit.

Duke parë se një nder problemet kryesore në përmirësimin e kualitetit të qumështit është se fermerët nuk kane pajisje adekuate për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit, IADK ka përkrahur 8 fermerë me pajisje për ftohjen dhe ruajtjen e qumështit, me kapacitet te grumbullimit te qumeshtit 4500 litër



qumësht ne dite. Tek të gjithë përfituesit është rregulluar dhoma për vendosjen e pajisjeve sipas standardeve që kërkohen dhe janë instaluar laktofrizat me kapacitet nga 500 - 1000 litra, pompat për transportimin e qumështit nga laktofrizi në cisternën për grumbullim të qumështit, brushat adekuate për pastrim, acid dhe bazë për pastrim të laktofrizave, pajisje për analizat kimike të qumështit (Ekomilk), rregullator te rrymës, gjeneratorët e rrymës dhe qeramikat e nevojshme për hapësirën e dhomës se qumeshtit dhe pajisje tjera sanitare. Pas instalimit të pajisjeve, fermerët janë trajnuar rreth përdorimit te pajisjeve, përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe menaxhimin e fermave qumështore.

Shpërndarja e makinave mjelëse

Në kuadër të aktiviteteve në sektorin e blegtorisë, IADK rendësi të veçantë i ka dhënë përmirësimit të kualitetit të qumështit dhe përmirësimit të kushteve në ferme. Në kuadër të kësaj IADK ka përkrahur 4 fermerë nga minoriteti serb nga komuna e Vushtrisë dhe Skenderajt me nga një makine mjelëse për lopë. Te gjithë përfituesit janë trajnuar ne përdorimin e makinave mjelëse dhe në përmirësimin e kualitetit të qumështit.



Ujë pirëse për lopë

Me qellim te përmirësimit te infrastrukturës se fermave qumështore, gjatë këtij viti IADK ka përkrahur 12 fermerë ne instalimin e sistemit te ujit ne ferme te cilët kane 162 krerë gjedhe. Ne kuadër te këtij aktiviteti fermerët kane përfutuar ujë pirëset për lope (82 ujë pirëse) dhe gypat me pajisjet tjera përcjellëse për instalimin e ujit. Pas instalimit te ujit ne fermer lopët do te kenë sasi te mjaftueshme te ujit dhe kjo do te ndikojë pozitivisht në shëndetin e lopëve dhe gjithashtu fermerët do ta kenë me lehtë në menaxhimin e fermave.

Implementimi i praktikave te mira te menaxhimit te pikave grumbulluese te qumeshtit (GMP)

Gjatë vitit 2012 IADK ka filluar ne implementimin e standardit te GMP ne pikat grumbulluese te qumeshtit. Gjatë këtij viti janë përgatitur te gjitha dokumentacionet e nevojshme qe kërkon standardi dhe është filluar zbatimi i GMP ne një pike grumbulluese te qumeshtit. Gjatë kësaj kohe janë përgatite te procedurat qe kërkohen ne baze te standardit dhe trajnimi i stafit te pikës

grumbulluese te qumeshtit. Zbatimi i GMP është duke u implementuar nga pika grumbulluese e qumeshtit. IADK gjatë viteve te ardhshme ka ne plan ne implementimin e GMP ne se paku 6 pika tjera grumbulluese te qumeshtit.

Themelimi i shoqatës se deleve dhe dhive

Sektori i deleve dhe dhive është shume i rëndësishëm dhe mjaftë i ndjeshme për shkak te strukturës se fermave dhe organizimit te tyre. Ne Kosovë ekzistojnë disa shoqata regjionale por ne përgjithësi ky sektor nuk është i organizuar dhe nuk është i përfaqësuar nga një shoqate ne nivel te Kosovës. Për këtë qellim IADK gjatë këtij viti ka filluar ne themelimin e shoqatës se deleve dhe dhive ne nivel te Kosovës ku gjatë këtij viti janë përgatitur te gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e kesaj shoqate.

Me qellim te përfaqësimit sa me te madhe te fermerëve, janë organizuar takime dhe grupe punuese me fermerët ku se bashku me përfaqësuesit e fermerëve janë zgjedhur organet udhëheqëse te shoqatës, janë përgatitur statuti i shoqatës dhe është bere aplikim për regjistrim i shoqatës ne organet përkatëse.

IADK do te vazhdoj qe te mbështes shoqatën e deleve dhe dhive ne ngritjen e kapaciteteve menaxhuse te shoqatës.

Organizimi i vizitës së fermerëve nga Maqedonia në Kosovë

Gjatë këtij viti, IADK ka organizuar vizitë studimore në Kosovë për fermerët nga Maqedonia. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë 14 fermerëve prodhues të qumështit dhe ushqimit te kafshëve. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët nga Maqedonia të njihen me eksperiencat e fermerëve Kosovarë dhe të behet shkëmbimi i përvojave të tyre. Gjatë kësaj vizite janë vizituar fermerë të ndryshëm ku gjatë vizitave fermerët nga Maqedonia kanë pasur rastin të njihen me standardet dhe kriteret për kualitet të qumështit në Kosove, mënyrën e grumbullimit te qumështit, të ushqyerit e lopëve dhe menaxhimin e fermave të lopëve qumështore dhe funksionimin e model fermës se lopëve qumështore.

ORGANIZIMI I FERMERËVE

Fermerët nuk luajnë rol aktiv në zhvillimin e kornizës së sektorit për shkak të mungesës së përfaqësimit efektiv në nivel nacional. Rreth 350 organizata ose shoqata të regjistruara të fermerëve dhe kooperativa bujqësore janë të shpërndara në vend. Disa nga organizatat janë themeluar me vet-iniciativë të fermerëve dhe disa të tjera me mbështetje të donatorëve. Sidoqoftë, vetëm disa prej tyre janë funksionale dhe disa organizata të bazuara në sektor kanë krijuar strukturat nacionale, siç është unioni i bletarëve, shoqata e prodhuesve të qumështit, përpunuesve te qumeshtit, unioni i pentërave, shoqata e shpezetarisë etj.

IADK ka grumbulluar përvojat e para me shoqatat e fermerëve në nivelin fillestar të regjionit të Mitrovicës dhe Ballkanit (BAAN). Për IADK-ne, shoqatat e fermerëve janë partnerët kyç për bashkëpunim dhe janë të përfshira në të gjitha nivelet e planifikimit dhe implementimit të projekteve.

Në projektin e ri “Edukimi dhe konsolidimi i fermerëve në Kosovë 2012-2014 “ si komponentë është edhe organizimi fermerëve me objektivin që Organizata e Fermerëve në nivel nacional e organizuar mirë (OFN) është aktive në Kosovë dhe e përfaqësuar në rrjetet ballkanike dhe Evropiane .



Gjatë këtij viti në këtë komponent janë zhvilluar këto aktivitete

Hulumtimi lidhur me identifikimin e shoqatave të fermerëve të cilat funksionojnë apo kryejnë aktivitete për anëtarët e vet . Në fillim është zhvilluar pyetësori, ku janë intervistuar 120 shoqata.

Në bazë të hulumtimit janë identifikuar 101 shoqata të cilat funksionojnë ku numri i përgjithshëm i anëtarëve është 14,055 ku 79,50 % janë anëtarë të gjinisë mashkullore kurse 20,50 % janë anëtare të gjinisë femërore.

Këto shoqata janë të organizuar në rrjete, unione në të gjitha sektorët, ku 99% e shoqatave e përkrahin organizimin në nivel kombëtar ndërsa vetëm 1% nuk e shohin si të domosdoshëm organizimin e fermerëve në nivel kombëtar.

Në fillim të prillit 2012 është nënshkruar memorandum i mirëkuptimit në mes të IADK-se dhe MBPZHR Ky memorandum fokusohet në:



Bashkëpunimi në mes të MBPZHR-së dhe IADK, mbi të drejtat dhe detyrimet e secilës palë të përfshira në procesin e organizimit të fermerëve në nivel kombëtar. Një përfaqësim më të madh të fermerëve në nivel kombëtar do të kontribuojë në konsolidimin e mëtejshëm demokratik, zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe

përgatitja e fermerëve për përmbushjen e standardeve të fituara për anëtarësim në BE.

Konferenca Ballanike e Shoqatave të fermerëve -BAAN

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë IADK është pjesë e Rrjetit të Shoqatave Bujqësore në Ballkan - **BAAN**, e themeluar në vitin 2008 nga shoqatat e ndryshme të Ballkanit (Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnja, Mali i Zi dhe Serbia).

IADK gjatë këtij viti ka organizuar takimin e 7-të të “Rrjetit të Shoqatave të Bujqësisë në Ballkan” (BAAN), i cili është mbajtur në Prishtinë me 28 dhe 29 Qershor 2012 me teme “Mundësitë e reja të bashkëpunimit në mes të anëtarëve të BAAN-it”.



Me qëllim të organizimit sa më të mirë të fermerëve në nivel nacional, IADK gjatë këtij viti ka angazhuar konsulentët Sten Rune Lundin në një mision dhe në dy misione Johan Van Der Bergut nga organizata (PUP) . Gjatë misioneve konsulentët janë angazhuar me komitetin drejtues si dhe në takimet me shoqata të fermerëve ku janë shtjelluar dhe analizuar planet e punës për organizim të fermerëve në nivel kombëtar deri me vitin 2014.

Vizite studimore

Vizita në Maqedoni IADK se bashku me 4 anëtarë të komitetit drejtues ka vizituar Maqedoni prej datës 15-17 gusht me qëllim për të kuptuar praktikën më të mirë të organizimit dhe funksionimit të përfaqësimit të fermerëve në Maqedoni . Është vizituar Federata e Fermerëve të Maqedonisë, qendra regjionale të kësaj Federate në Manastir etj. Përvojat e marra nga kjo vizite do të përshtatet me kushtet dhe mentalitetin e fermerëve në Kosovë për organizimin e një përfaqësimi kombëtar. Kjo vizite do të ndihmojë për të identifikuar organizatën më të përshtatshme në drejtim të sektorëve, regjioneve apo formave të tjera demokratike të organizimit të fermerëve në nivel kombëtar



Vizita në Hungari Është organizuar vizite studimore ne Hungari prej 19-24 Nëntor me 5 anëtarët e komitetit drejtues, një staf të IADK dhe zyrtarin e lartë për koordinim me OJQ pranë Ministrisë së Bujqësisë . Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi me format e organizimit të fermerëve, shoqatave të fermerëve në nivel qendror në Hungari. Gjatë kësaj vizite janë vizituar federate të ndryshme si federata e fermerëve të vegjël **MAGOSZ**, Federata kombëtare e prodhuesve dhe kooperuesve bujqësor –**MOSZ**, oda e bujqësisë së Hungarisë etj. Pjesëmarrësit e kësaj vizite janë njoftuar me mënyrën e funksionimit të këtyre federatave , qendrueshmerine financiare , përfitimi dhe implementimi i projekteve të ndryshme nga BE.

Në fund të vitit është organizuar “**Punëtori Nacional e palëve në interes për të diskutuar faktet dhe konceptin**” Në këtë punëtori kanë marrë pjesë pjesëmarrës nga shoqata të ndryshme të fermerëve, zyrtarë të komunave të ndryshme të Kosovës, Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës, student të Fakultetit të Bujqësisë, konsulent të ndryshëm etj.



Në këtë punëtori është diskutuar organizimi në baza sektoriale por pa i harruar edhe formën e organizimit regjional, të bëhet një kombinim në mes të organizimit sektorial dhe regjional. Është diskutuar edhe qëndrueshmëria financiare e cila mund të sigurohet nëpërmjet anëtarësisë, ndikimit në ligje të ndryshme, nga projekte të ndryshme , si dhe forma të tjera si janë shërbimet këshillimore

DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Qendra përpunuese e frutave

Kjo qendër përpunuese e ngritur vitin e kaluar në përkrahje të IADK-së, në fshatin Klinë e Epërme të Skenderajt, gjatë vitit ka vazhduar punën në përpunimin e frutave të pemëve si kumbull, dredhëz, mjedër, manaferrë dhe frutave të perimeve (domate, spec), dhe po ashtu është shfrytëzuar edhe si qendër e organizimit të kurseve praktike trajnuese në përpunimin e frutave të pemëve dhe perimeve, për grupe të grave nga regjioni i Mitrovicës. Për standardizim të produkteve dhe qasje më të mirë në treg, qendra përpunuese është përkrahur edhe me dy aparate plotësuese (refraktor-metë, i cili matë përqindjen e sheqerit dhe Ph- metër, që matë aciditetin në produktet e përpunuara).

Po ashtu me qëllim të avancimit të teknologjisë së përpunimit të frutave të pemëve dhe perimeve, ngritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të qendrës përpunuese, stafit të departamentit të përpunimit të vet IADK-së dhe grupeve të grave, edhe këtë vit është angazhuar një ekspert i teknologjisë së përpunimit, i cili ka mbajtur dy sesione praktike të trajnimeve në përpunimin e katër llojeve të produkteve tjera, ku kanë marrë pjesë 37 pjesëmarrës.

Në kohën e vjeljes së dredhëzave grupet e grave nga Navalani, Broboniqi dhe Klina kanë sjellë dredhëzat nga fermat e tyre në qendrën përpunuese, të cilat i kanë përpunuar dhe në këtë rast ato janë njohur me këtë teknologji përpunuese.



Ngritja e kësaj qendre përpunuese është vërejtur se ka pas ndikim te fermerët e kësaj rrethine në zgjerimin e sipërfaqeve me pemë, sidomos me fruta të imëta (dredhëza, mjedra, manaferra). Në këtë rast vetëm pronari i qendrës përpunuese ka shtuar për 25 ari sipërfaqet me dredhëza, mbi 0.5 ha me kumbull, ka filluar me kultivimin e perimeve në fushë të hapur, si dhe ka filluar investimet në ngritjen e një plantacioni me sipërfaqe prej 0.40 ha me mjedër dhe manaferrë. Këso investimesh vërehen edhe te fermerët tjerë, që do të thotë se vit pas viti do të rriten sipërfaqet me kultura të ndryshme bujqësore, e sidomos me fruta të imëta dhe kështu do të kemi edhe rritje të lëndës së parë për qendrën përpunuese, përkatësisht rritje të shfrytëzimit të kapaciteteve të saj përpunuese.

Trajnimet ne përpunim shtëpiak, produkte te orientuara për treg (perime, fruta dhe djathë)

Trajnimet ne modulën e qumeshtit

Ne këtë grup janë trajnuar 17 gra nga komunat e Podujevës dhe Drenasit. Posedimi i lëndës së parë - qumeshtit për përpunim si dhe orientimi për treg kanë qene kriteret kryesore për përzgjedhjen e këtyre kandidatëve për këtë modul.

Ky modul ka përmbajtur 20 sesione ku gratë janë trajnuar ne prodhimin e 5 llojeve te ndryshme te djathit.



Përzgjedhja e këtyre llojeve të djathit është bere ne baze të hulumtimit nga vitet e kaluara d.m.th sipas kërkesave të tregut.

Nga ky numër i kandidatëve , 8 gra kanë filluar të shesin lloje të ndryshme të djathërave në Prishtinë, Podujevë, Drenas në vlerë prej 15,418 euro.

Trajnimet në modulën e pemëve

Janë formuar 2 grupe të grave në Komunën e Vushtrrisë dhe Skenderajt . Gjatë këtyre trajnimeve 30 gra janë aftësuar në përpunimin e xhemave dhe reçelrave të ndryshëm nga peme të ndryshme. Trajnimet praktike janë mbajtur në pikat përpunuese të cilat janë përkrahur me herët nga IADK e që shërbejnë edhe si pika demonstruese për grupet e grave



Nga 30 të cilat kanë përfunduar trajnimet në këtë modul ,12 prej tyre kanë filluar shitjen e produkteve të tyre në vlerë prej 3,997.5 euro.

Trajnime në modulën e perimeve

Trajnimet në modulën e perimeve janë organizuar në fshatin Frashër të komunës së Mitrovicës ku kanë marrë pjesë 15 kandidatë të cilat janë aftësuar në përpunimin 5 llojeve të turshive në baze të kërkesave të tregut.

8 kandidatë kanë përpunuar produkte për treg në vlerë prej 3,535.5 euro. Ky grup pjesën praktike të trajnimeve i ka mbajtur në pikën përpunuese në Studime, pike e përkrahur nga IADK.

Të gjitha kandidatet të cilat kanë përpunuar produkte për treg në tri modulet kanë gjetur treg nëpërmes pjesëmarrjes në panairë të ndryshme, nëpërmjet të pikës degustuese dhe promovuse të organizuar nga IADK-ja në qendra tregtare në Prishtinë si "ETC", "Viva Fresh" ku janë krijuar kontakte të ndryshme e si rezultat i saj gratë kanë filluar të prodhojnë produkte për restorante të njohura në Prishtinë siç janë "Shpija e vjetër", "Agora" etj.

Trajnimi i grave në aspektin ekonomik të prodhimit/përpunimit

Përveç trajnimeve në aspektin teknik janë organizuar edhe 5 sesione të trajnimeve ekonomike lidhur me biznesin, në mbajtjen e shënimeve, menaxhimi i fermës, kalkulimin e shpenzimeve, marketing dhe promovim të produktit

Pjesëmarrëset e trajnimeve të cilat kanë filluar të përpunojnë produkte për treg kanë filluar mbajtjen e shënimeve si dhe kalkulimin e kostos së prodhimit. Po ashtu kanë filluar të përdorin etiketa si pjesë të promovimit të produktit.

Promovimi i produkteve

IADK ka organizuar pika degustuese dhe promovuese ne dy qendra te mëdha tregtare ne “ETC” dhe VIVA FRESH”. Promovimi është bere ne tri vikende te çdo muaji. Po ashtu është përgatitur forma e vlerësimit ku konsumatorët gjatë degustimit te produkteve kane dhenë vlerësimet e tyre. Edhe pse kjo ngjarje nuk është planifikuar për shitje te produkteve me insistimin e konsumatoreve është bere edhe shitja e produkteve ne vlere prej 1,656.00 euro. Gratë te cilat merren me përpunimin e produkteve për treg kane marre pjese ne panaiere te ndryshme



1. Festivali “ETNO dhe AGRO Festë”-7 gra
2. Panairi i trashëgimisë kulturore –4 gra
3. Panairi i produkteve bujqësore-MBPZHR dhe OEK – 19 gra
4. Panairi i javës se biznesit kombëtare –9 gra
5. Panairi i Prishtinës – 3 gra
6. Panairi “Agrokos” –CeoKos -11
7. Panairi regjional “ Mitrovica 2012- 21 gra
8. Panairi për nder te 100 vjetorit te Pavarësisë-Skenderaj-3 gra

Është bere njoftim ne radion lokale “Ylberi” për promovimin e produkteve te 5 pikave përpunuese dhe grave te orientuara për treg.

Tryeze e rrumbullaket me te gjithë partneret ne zinxhirin e vlerave për ushqimin e përpunuar shtëpiak

Me qellim te bashkëpunimit te gjithë palëve te interesit te sektorit te përpunimit shtëpiak dhe mundësisë se krijimit te një ombrelle te shoqatave qe merren me përpunim shtëpiak është organizuar tryeza e rrumbullaket ku janë diskutuar qeshtje qe do t ju shkonte ne interesin e te gjitha palëve dhe mundësitë e bashkëpunimit mes tyre. Ne këtë tryeze kane marre pjese përfaqësuese te shoqatave te grave te cilat merren me përpunimin e ushqimit.



Nga kjo tryeze janë dal këto rekomandime:

Te punohet ne funksionalizimi te idesë për krijimin e ombrellës se shoqatave te grave qe merren me përpunimin e ushqimit si dhe te fillohet menjëherë me bashkëpunim ne mes përpunueseve për porositjen inputeve si dhe te aktiviteteve te përbashkëta.

Përcjellja e te gjitha njësive te themeluara te përpunimit: organizimin e trajnimeve shtese dhe avancimit

5 pikat përpunuese te themeluar nga IADK gjatë viteve 2009-2011 si grupet e krijuara gjatë viteve te kaluara, veçanërisht ato te cilat prodhojnë treg për janë përcjellur dhe përkrahur ne zhvillimin e biznesit te tyre. Pikat përpunuese dhe gratë aktive ne treg kane zhvilluar aktivitetet e tyre ku gjatë zezonës se shitjes kane bere shitje ne vlere prej 21,713.00 Euro. Është përkrahur Iniciativa e grupit te grave nga komuna e Vushtrisë dhe Mitrovicë për themelimin e shoqatës se grave “Vullneti i grave ” ne Vushtri, Kjo përkrahje ka konsistuar ne aktet e themelimit, përgatitjen e dokumentacioneve për regjistrim, trajnime te ndryshme për menaxhimin e shoqatës si dhe ne fund me inventarin për zyre te shoqatës me qellim te funksionimit sa me te mire te saj



Përmirësimi i kualitetit te prodhimeve dhe standardizimi

Gjatë vitit 2012 është realizuar misioni i ekspertes nga Holanda, mision i cili është fokusuar ne ngritjen e kapaciteteve te shoqatave te grave , stafit te IADK-se ne standardizimin e produkteve.

3 Përfaqësuese nga IADK dhe 83 pjesëmarrës morën pjesë gjatë 9 ditëve të trajnimeve të ekspertes se PUM-it në standardizimin e produktit.

Po ashtu gjatë misionit te konsulentes është mbajtur punëtorja “**Kualiteti dhe standardizimi i produkteve**” ku kane marre pjese 26 pjesëmarrës. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që të sjellë së bashku të gjitha paletë e



interesit përfshira në sektorin e përpunimit dhe për të diskutuar problemet, sfidat, të mundësive dhe të ardhmen për rritjen e kualitetit te produkteve dhe standardizimin e tyre, duke gjetur rrugën për të zgjidhur problemet.

Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi ekonomik i grave te reja

Njëra nga synimet e IADK-se është fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve te grave te veja ne regionin e Mitrovicës.

Janë identifikuar tri grupe te grave te veja te cilat kane filluar me biznes apo kane shpreh interesim për te filluar biznes me qellim te krijimit te ardhurave për familjet e tyre.

Grupi i pare është identifikuar ne Mitrovice ku katër gra te veja kane zhvilluar biznesin ne gjimnazin “Frang Bardhi” Mitrovice, përgatitjen e ushqimeve (brumëra te ndryshme) për nxënësit e kësaj shkolle.

Për shkak te efijences se punës tyre dhe higjienës IADK ka përkrahur këto gra me pajisje te reja për përgatitjen e ushqimit.

Ne fshatin Morine, Komuna e Skenderajt 4 gra te veja kane bere prodhimin e djathit për treg ne kushtet e shtëpisë. Me qëllim që këtyre grave te veja t’i lehtësohet puna në përpunimin dhe ruajtjen e djathit, IADK i ka përkrah me pajisje për përpunimin dhe ruajtjen e djathit.

Shoqata “ Martiret e Lirisë “Vushtrri zhvillon aktivitete humanitare me gra te veja te komunës se Vushtrrisë. Se bashku me Kuvendit Komunal është gjetur hapësira për fillimin e biznesit ne shkollën fillore “Anton Zako Cajupi” Vushtrri ku këto përveç mundësisë se përgatitjes se ushqimit me porosi do te mund te përgatisin edhe ushqim për nxënësit dhe stafin e kësaj shkolle. IADK ka pajisur këtë grup te grave me pajisje te nevojshme për fillimin e këtij biznesit.



Bashkëpunimi me RRGK dhe partneret tjerë ne Kosove

Ne fillim te vitit 2012 IADK ka nënshkruar memorandumin e mirëkuptimin me Rrjetin e Grupeve te Grave te Kosovës (RrGGK). Qëllimi i këtij memorandumi është për te shkëmbyer ekspertet dhe ekspertizën për nevojat e grave (dhe për grupet e saj).

Gjatë vitit 2012 ekspertja e IADK ka ofruar trajnime ne përpunimin e qumeshtit për shoqatën “Kalabria” komuna e Fushe Kosovës .

Po ashtu IADK ka përkrahur RrGGK –ne ne mbajtjen e takimit me anëtarët e saj ne Mitrovice, ku ushqimi



tradicional i servuar ne këtë takim është përgatitur nga anëtarët e shoqatës së grave "Begatia" Runik e përkrahur nga IADK.

IADK ka inkurajuar shoqatën "Begatia" nga Runiku i Skenderajt dhe shoqatën "Konvita" nga Dolaku i Vushtrrisë për t'ju bashkuar RRGK, ku që nga shtatori i vitit 2012 shoqata "Begatia" është bërë anëtarë e rregullte e RrGGK-se.

Aktivite shtese ne sektorin e përpunimit

Ne Shipol komuna e Mitrovicës, është vizituar rasti i një familjes e cila ka gjashtë anëtarë ku bashkëshorti dhe katër fëmijët janë të retarduar. Zonja e familjes merret me përpunimin e qumeshtit duke bërë djathë, ku me shitjen e produkteve ajo kujdeset për medikamentet për fëmijët dhe mbajtjen e familjes.

Pas kësaj vizite IADK ka përkrahur këtë grua me pajisje të cilat i nevojiten gjatë punës së përpunimit të djathit.

Fuqizimi i Shoqatës së grave "Begatia" në Runik, Skenderaj

Me qëllim të funksionimit të mirë dhe për një punë të suksesshme, IADK ka përkrahur shoqatën me inventar për zyre. Shoqata ka filluar aktivitetet e natyrave të ndryshme me gratë në zonat rurale, përgatitjen e ushqimeve tradicionale me porosi, përgatitjen e dokumenteve etj.

Në mënyrë që të mundësohet një menaxhim më të mirë të Shoqatës dhe për shkak të mungesës së përvojës në funksionimin e shoqatës, projekti mbështeti shoqatën me 8 sesione trajnimesh të mbajtura nga eksperti i jashtëm, ku morën pjesë 15 gra në çdo seancë.

IADK së bashku me anëtarët e manxhmentit të shoqatës "Begatia" kanë zhvilluar planin biznesin e shoqatës.

Shoqata do të fokusohet në tre fusha kryesore: a) Përpunimi i ushqimit b) Përgatitja e ushqimit tradicional, c) Prodhimtaria e luleve.

Me qëllim të fuqizimit të menaxhmentit të shoqatës "Begatia" Runik për funksionimin sa më të mirë të saj, IADK ka përkrahur tre anëtarë të bordit të Shoqatës të ndjekin kursin e kompjuterit dhe kursin e gjuhës angleze.



Visit studimore ne Kosovë dhe në vende fqinjë

Vizita ne Kosove Me qëllim të shkëmbimit të përvojave 51 gratë nga tri grupet e grave, Kline e Epërme, Novolan dhe Broboniq kanë vizituar tri pika përpunuese në fshatin Babaj Bokes, Komuna e Gjakovës, fshati Banja e Komunës së Malishevës dhe në Babush i Muhaxherve i Komunës së Lipjanit.

Vizitat në rajon (në Maqedoni dhe në Shqipëri): 5 anëtarët e shoqatës kanë qenë në një vizitë 3 ditë në Maqedoni dhe 3 ditë vizitë në Shqipëri, ku ato kanë vizituar 10 Shoqata e Grave në të dy vendet. Këto vizita janë bërë me qëllim të mësimin praktikave më të mira në funksionimin e shoqatave të grave.




PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2012 IADK ka përgatitur dhe publikuar 7 broshura dhe 4 flet palosje ne te gjithë sektorët e bujqësisë. Broshurat janë përgatitur ne tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Broshura **“Menaxhimi i fermave të lopëve qumështore”**. Broshura është e pasur me material praktik për nevojat e fermerëve e cila është e ilustruar edhe me fotografi.

Broshura **“Kultivimi i perimeve në serra”** – përmban tema të rëndësishme në kultivimin e perimeve në serra duke filluar nga teknikat e prodhimit të fidanëve, teknikat e kultivimit të perimeve në serra, si specit, trangullit, domates, sallatës, spinaqit, prodhimin e integruar të perimeve, dhe disa njohuri për mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

Broshura **“Praktika mbi prodhimin intensiv të mollës”** – përmban përmbledhje lehtësisht të kuptueshme për fermerët që duan të fillojnë me ngritjen e pemishteve intensive me mollë. Në broshurë janë përshkruar kushtet klimatiko-tokësore për ngritjen e pemishtes, përshkrimi i disa kultivarëve më të preferuar, kostoja e ngritjes së pemishtes, teknikat e ngritjes dhe kultivimit të mollës dhe vjelja e deponimi i frutave.



Broshura **“Sistemet e kultivimit të dredhëzës”**- përmban faktorët ekologjik për kultivimin e dredhëzës dhe teknikat e ndryshme të kultivimit të saj si në ambiente të mbyllura ashtu edhe në fushë të hapur, përshkrimi i kultivarëve të preferuar, dhe masat e përkujdesjes gjatë vegjetacionit deri në vjeljen dhe ruajtjen e frutave.

Broshura **“Mënyrat e shumimit të dredhëzës”**- ne këtë broshurë janë paraqitur mënyrat e shumimit të dredhëzave dhe teknikat e prodhimit të materialit fidanor të dredhëzës.

Broshura **“Prodhimtaria organike te bimët mjekësore dhe kultivimi i tyre”**- përmban një përmbledhje të rëndësishme të prodhimitarisë organike të bimëve mjekësore, kushtet për kultivimin e këtyre bimëve, teknikat e kultivimit të nëntë bimëve të ndryshme mjekësore.

Broshura **“Menaxhimi biznesor i fermës”** – ne këtë broshurë fermeri mundet të merr njohur lidhur me menaxhimin e fermave, përgatitjen e biznes planeve, siç fillohet me një biznes të ri.

Janë përgatitur nga një fletëpalosje për dredhëz dhe mollë **“Përdorimi i pesticideve në menaxhimin e integruar të dëmtuesve të molla dhe “Përdorimi i pesticideve në menaxhimin e integruar të dëmtuesve të dredhëza ”** - në të cilat janë përshkruar lista e gjelbër e verdhë dhe e kuqe e pesticideve.

Fletëpalosje **“Prodhimtaria organike bujqësore”**- përmban disa parime bazike të prodhimit organik bujqësor.

Fletëpalosje **“Prodhimtaria organike e bimëve mjekësore, aromatike dhe mëlmesave”**- përmban një përmbledhje të shkurtër të kushteve dhe teknikave të prodhimit organik të këtyre bimëve.



Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org

PANAIRE

Edhe këtë vit IADK ka përkrahur në forma të ndryshme organizimet bujqësore, si janë “Dita e Dredhëzës 2012”, i mbajtur në Skenderaj, “Panairi i shitjes së frutave të imëta dhe dredhëzave në Prishtinë, “Panairi Regjional i Produkteve Bujqësore Mitrovica 2012” etj.

“Dita e dredhëzës 2012”

Më 8 Qershor në fshatin Llaushë të Skenderajt, nën organizimin e përbashkët të MBPZHR, Komunës së Skenderajt, IADK-së, Agjencisë për Zhvillim Rajonal Veri dhe Qendrës Rajonale të Bizneseve Familjare është mbajtur “Dita e Dredhëzës 2012”. Në këtë organizim ku kanë marrë pjesë edhe Ministri i Bujqësisë dhe përfaqësues tjerë të institucioneve publike dhe vizitor të ndryshëm, fermerët kultivues të dredhëzave nga Kosova kanë ekspozuar prodhimet e tyre, ndërsa janë ndarë edhe shpërblime dhe mirënjohje për kultivuesit më të suksesshëm të dredhëzës. Ndërsa promovimi i dredhëzës ka vazhduar edhe nga data 12-18 qershor përmes organizimit të Panairit “Dredhëza 2012” në mbështetje të MBPZHR, NOA/USAID dhe IADK-së, që është mbajtur në sheshin “Nëna Terezë” në Prishtinë, ku prodhues të shumtë nga gjithë Kosova kanë ekspozuar dhe shitur fruta të freskëta të dredhëzës.



Po ashtu në këtë vit nga data 23-27 korrik për herë të parë në Prishtinë, është organizuar panairi i frutave të imëta “Manaferra 2012” në mbështetje të përbashkët nga MBPZHR-ja, USAID/NOA, IADK-ja dhe HPK “Rinvest”, në të cilin 10 kultivues nga zona të ndryshme të Kosovës kanë bërë promovimin e manaferrës vendore përmes shitjes së drejtpërdrejtë në sheshin “Nëna Terezë”.



Panairi Regjional i Produkteve Bujqësore “Mitrovica 2012”

Ky panair është mbajtur më 5 dhe 6 tetor 2012, në Mitrovicë dhe bartës kryesor i këtij organizimi ka qenë USHFRM (Unioni i Shoqatave të Fermerëve në Regjionin e Mitrovicës), i mbështetur nga Qendra Rajonale e Bizneseve Familjare, komuna e Mitrovicës, Skenderajt dhe Vushtrrisë, si dhe disa sponsor tjerë. Edhe në këtë panair IADK ka ndihmuar fermerët në organizimin dhe promovimin e produkteve të ndryshme bujqësore. Në këtë rast fermerët kanë ekspozuar prodhimet bujqësore nga sektorë të ndryshëm të bujqësisë si pemë, prime, produkte blegtorale, prodhime të përpunuara dhe të konservuara, gjëra artizanale etj.



AKTIVITETE ME PARTNERË PROFESIONAL INTERNACIONAL

Ekspertët Seniorë të PUM nga Holanda

Në sektorin e blegtorisë gjatë vitit 2012 janë realizuar dy vizita nga një ekspert nga organizata PUM. Gjatë kësaj vizite fermerët janë trajnuar dhe janë këshilluar në parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve, të ushqyerit e kafshëve, përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe në implementimin e GMP në pikat grumbulluese të qumështit.

Në sektorin hortikulturës janë realizuar disa misione të ekspertëve regjional, ekspertëve të PUM-it, dhe eksperti gjerman për energji alternative.

Misioni i parë është realizuar nga data 18-26.03.2012 me agjendë “Krasitja e pemëve dhe sistemet e kurorave”

Misioni i dytë është realizuar nga data 04-09.06.2012 me agjendë “Sëmundjet dhe dëmtuesit e mollës”

Misioni i tretë është realizuar nga data 10-19.09.2012 me agjendë “Prodhimtaria organike e perimeve”

Ne sektorin e përpunimit është angazhuar një ekspert për përpunimin e ushqimit të cila është fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të shoqatave të grave, stafit të IADK-se në standardizimin e produkteve ushqimore.

Ne sektorin e organizimit të fermerëve është angazhuar eksperti Johan Van Der Berg i cili ka dhënë një kontribut rreth përgatitjes së strategjisë lidhur me organizimin e fermerëve në nivel nacional.

Gjatë viti 2012 ekspertet nga organizata e PUM kane trajnuar 64 student nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ne tema te ndryshme, 65 këshilltarë te bujqësisë dhe 322 fermerë nga te gjithë sektorët e bujqësisë.

Misioni i ekspertit nga Gjermania për energji alternative është realizuar nga data 18-27.09.2012, i cili ka bërë një studim fizibiliteti për përdorimin e energjisë alternative në sektorë të ndryshëm të bujqësisë.

Dy misione dhjetë ditore të ekspertëve regjional (nga Shqipëria) janë realizuar në sektorin e hortikulturës (peme dhe perime) dhe misioni i tyre ka qenë ngritja e kapaciteteve të stafit të hortikulturës në fushën e prodhimitarisë së integruar të pemëve dhe perimeve, si dhe përgatitja e moduleve të trajnimeve për prodhimitarinë e integruar.

Shkëmbimi i përvojave me organizatën AFDI nga Franca

AFDI është shoqatë nga Franca me te cilën IADK ka një bashkëpunim ne shkëmbimin e përvojave. Gjatë vitit 2012 përfaqësuesit e AFDI-t kanë realizuar një vizite në Kosovë me qellim që t'u ndihmohet fermerëve në menaxhimin sa më të mire të fermave në rritjen e produktivitetit te fermës. Po ashtu gjatë këtij misioni është bere evalumi i aktiviteteve qe ka pasur AFDI dhe IADK.

Po ashtu gjatë këtij vitit IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë ku kanë marrë pjesë tre punëtor te IADK. Vizita ka zgjatur 10 ditë dhe qëllimi kryesor i vizitës ka qenë që stafi i IADK te njihet me praktikat e reja ne menaxhimin e fermave, marrjen e njohurive ne prodhimin e energjisë alternative ne sektorin e bujqësisë, organizimin e fermerëve në shoqata.



Implementimi i standardit ISO 9001-2008 ne IADK

Me qellim te ngritjes se cilësisë se shërbimeve dhe përfomances se punës, IADK gjate vitit 2012 ka filluar me implementimin e standardit ISO 9001-2008. Te gjitha dokumentet dhe procedurat e ngritjes se sistemit janë përgatitur dhe është filluar ne implementimin e standardit. Po ashtu IADK ka angazhuar kompaninë certifikues Bureau Veritas nga Kroacia për certifikimin e IADK me standardin ISO 9001 - 2008.

Tregim sukcesi

Xhevrije Doroci, është njëra nga gratë fermerë që me punën në sektorin e bujqësisë po tregohet shumë e suksesshme.

Xhevrija jeton në fshatin Broboniq komuna e Mitrovicës. Ajo është nënë e 3 fëmijëve. Familja e saj posedon 2 ha toke ku me parë kanë kultivuar perime dhe drithëra për nevojat vetanake. Gjatë periudhës 1993 deri në fund të 1999 Xhevrija me familje ka jetuar në Gjermani. Pas përfundimit të luftës ajo është kthyer për të jetuar në Kosovë.

Në vitin 2008 bashkëshorti i Xhevrijës është përkrahur nga IADK në kultivimin e 10 ari dredhëza. Duke parë se kultura e dredhëzës është e profitshme dhe siguron të ardhura të mira, kjo familje ka zgjeruar sipërfaqet me dredhëz ku sot posedon 60 ari. Po ashtu kjo familje posedon 40 ari me pemë siç janë qershia dhe kumbulle. Përveç që posedojnë token e vetë ajo merr 1 ha toke me qira për mbjelljen e specave.



Në vitin 2011 IADK ka organizuar dhe mbajtur trajnimet në modul të pemëve në fshatin Broboniq ku kanë marrë pjesë 15 gra nga ky fshat, ku pjesë e këtij grupi ka qenë edhe Zonja Xhevrije Doroci. Pas përfundimit të trajnimeve në modul të pemëve Zonja Xhevrije ka shpreh interesim në ndjekjen e trajnimeve në përpunimin e perimeve. Xhevrija këto trajnime i ka parë si mundësi të ngritjes së kapacitetit të saj në përpunimin e pemëve dhe perimeve në mënyrë që të bëjë shitjen e këtyre prodhimeve me qëllim të krijimit të ardhurave për vetë dhe familjen e saj. Pas përfundimit me sukses të trajnimeve Xhevrija është përkrahur nga organizata CDF me mjete për përpunimin e xhemave të ndryshëm, ajvarit etj. Pas futjes në funksion të këtyre mjeteve Xhevrija ka prodhuar lloje të ndryshme të produkteve si xheme dredhëze, pekmez dardhe, xhem të kumbullës, ajvar, sallate të përzier, dardha turshi, kornishone turshi, xhem xhenerike, reçelra të ndryshëm, lloje të ndryshme të turshive me një sasi rreth 2360 kg. Me përkrahjen e IADK-se, Xhevrija ka marrë pjesë në shumë panairë të organizuara në Kosovë ku deri më tani ka bërë shitjen e këtyre prodhimeve në vlerë prej 3,571.00 euro, ka krijuar kontakte të ndryshme si dhe është njoftuar me kërkesat

e tregut ku do ti shërbej për planifikimin e prodhimit e produkteve me se te kërkua nga tregu.

Me sigurimin e mjeteve Xhevrija mendon qe vitet ne vijim te rris kapacitetet ne minimum prej 5000 kg te produkteve te ndryshme.

Xhevrije Doroci shprehu se me fillimin e biznesit te saj ka ndikuar shume ne ndryshimin e jetës se saj , përveç qe ka ndikuar ne ngritjen e mirëqenies se familjes se saj, ka ndikuar edhe me shume ne jetën e saj si grua ne fuqizimin e saj, duke filluar nga familja po ashtu dhe në komunitet ndikimi i saj ne aspektin social, sepse po thyhen disa tabu që kanë ekzistuar më parë. Përpara ka ekzistuar mendimi se gruaja shqiptare nuk del të shes në treg. Ka qenë një tabu e paparamenduar, që një grua të dal dhe të shes në treg. Mirëpo sot Xhevrijen mund ta gjejmë në treg, në panairë dhe gjithkund dhe përkrah saj është burri i cili e përkrah. Këtu kemi ndërrim të rolit, gruaja është ajo liderë në udhëheqje të biznesit, ndërsa burrin e ka përkrah,

Vizitat me fermerë dhe pjesëmarrja në konferenca të ndryshme

N r.	Vendi	Kohëzgjatja	Nr.i pjesm.	Agjenda
1	Kosovë	1 ditore	16	Përpunimi i ushqimit
2	Kosovë	1 ditore	16	Përpunimi i ushqimit
3	Kosovë	1 ditore	17	Prodhimtaria e brokollit
4	Kosovë	1 ditore	11	Prodhimtaria e kornishonit
5	Kosovë	1 ditore	12	Prodhimtaria e mullages
6	Kosovë	1 ditore	17	Përpunimi i ushqimit
7	Shqipëri	3 ditore	8	Përpunimi i perimeve
8	Shqipëri	1 ditore	3	Prodhimtaria organike
9	Shqipëri	3 ditore	2	Përpunim i ushqimit
10	Maqedoni	3 ditore	5	Organizimi i fermerëve
11	Maqedoni	2 ditore	2	Konferencë rajonale
12	Maqedoni	3 Ditore	7	Përpunim i ushqimit
13	Maqedoni	1 Ditore	2	Organizimi i fermerëve
14	Vojvodine	3 ditore	2	Konferencë rajonale
15	Serbi	3 ditore	2	Prodhimtaria organike
16	Kroaci	3 ditore	1	Konferencë Ballkanike
17	Poloni	5 ditore	1	Seminar
18	Rep.Qeke	3 ditore	1	Vorkshop
19	Belgjike	3 ditore	1	Gruaja ne bujqësi
20	France	10 ditore	3	Vizite studimore
21	Hungari	5 ditore	6	Organizimi i fermerëve


Të hyrat e IADK-së nga Partnerët dhe Donatorët për vitin 2012

	Emri I Donatorit/Partnerit	Emri dhe Kohëzgjatja e Projektit	Shuma - 2012 €	%
1	Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë	Promovimi I Bujqësisë, Hortikulturës, Blegtorisë dhe Përpunimit të frutave në Regjionin e Mitrovicës (2010-2012)	124,079	13%
	Bashkëfinancim me Komunën e Mitrovicës		10,000	1%
2	Fin Church Aid	Edukimi dhe Konsolidimi I Fermerëve në Kosovë (2012-2014)	160,000	16%
	Evangelischer Entwicklungsdienst-EED		199,000	20%
	Church of Sweeden		112,660	11%
3	USAID/NOA-Mundësi të reja për bujqësi	Mbikëqyrja e Përfituesve për Kultivimin testues të Varieteteve të reja te Mollës 2012	34,200	3%
4	USAID/NOA-Mundësi të reja për bujqësi	Mbikëqyrja e Përfituesve për Kultivimin testues të Varieteteve të reja te Dredhëzës 2012	28,000	3%
5	AFDI Project	Shkëmbimi I përvojave (2011-2013)	1,500	0.2%
6	PUM - Vehicle Project	Ekspert nga Holanda (2011-2013)	4,101	0.4%
7	Evangelischer Entwicklungsdienst-EED	Qendra për Edukimin e Fermerëve (2012-2015)	152,000	15.5%
	Fin Church Aid		30,000	3.1%
8	Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë	Fuqizimi I kapaciteteve të shoqërisë civile ne bërjen e politikave dhe dialogut me Qeverinë në sektorin e Bujqësisë (2012-2014)	75,331	7.7%
9	Komuna e Drenasit	Qendra për Grumbullimin e Qumështit 2012	3,000	0.3%
10	Kontributi Lokal	Projektet 1,3,4,5	46,007	5%
Total			979,878	100%

Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a


*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadc.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadc.org



Invesimet e IADK-se ne sektoret e Bujqesisepërvitin 2012

	Emri I Sektorit	Shuma €për 2012	Përqindja %
1	SEKTORI I HORTIKULTURES	281,696	37%
2	SEKTORI I BLEGTORISE	226,028	29%
3	SEKTORI I PERPUNIMIT	76,083	10%
4	ORGANIZIMI I FERMEREVE	40,219	5%
5	SHPENZIMET KAPITALE PER QENDREN EDUKUESE BUJQESORE	107,517	14%
6	SHPENZIMET ADMINISTRATIVE	37,569	5%
	Total	769,111	100%



Stafi i IADK-së për vitin 2012

Emri&Mbiemri	Departamenti	Pozita
Zenel Bunjaku	Menaxhment	Drejtore Ekzekutiv
Gursel Arifi	Blegtori	Zëvendës Drejtore dhe Udhëheqës i departamentit të Blegtorisë
Esmā Azemi	Financa	Zyrtare e lartë për Financa dhe Admin.
Basri Hyseni	Hortikulturë	Udhëheqës i departamentit të Hortikulturës
Ariana Selmani	Financa	Zyrtare për Financa dhe Administratë
Shemsedin Aliu	Menaxhment	Menaxher i Zyrës
Elheme Shala	Administratë	Ndihmëse Teknike
Petrit Koci	IT / Administratë	Ndihmës i IT-së
Vahid Avdiu	Pemëtari-hortikulturë	Inxhinier larte i Bujqësisë
Sylejman Bunjaku	Perimtari	Inxhinier i Bujqësisë
Xhavit Shala	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
Xhavit Merovci	Blegtori	Asistent i Blegtorisë
Skender Fejzullahu	Pemëtari-hortikulturë	Asistent i Hortikulturës
Magbule Hyseni	Përpunim	Udhëheqëse e sektorit të përpunimit
Hanumshahe Zeneli	Përpunim	Zyrtare Projekti
Hafize Veseli	Përpunim	Zyrtare Projekti
Burim Morina	Administratë	Trajner biznesi
Boban Ristic	Hortikulturë	Asistent i Hortikulturës
Novica Markovic	Hortikulturë	Inxhinier i Hortikulturës

Konsulentet e jashtem dhe te brendshem gjatë vitit 2012

Emri&Mbiemri	Departamenti	Pozita
Fatmir Bytyqi	Administratë	Trajner
Zenel Elshani	Administratë	Trajner
Pandeli Pasko	Hortikulturë	Trajner
Zijadin Gojnovci	Blegtori	Trajner ne GMP
Stem Rune Lundin	Organizimi i fermerëve	Trajner
Bernd Sitzmann	Hortikulture	Konsulent për energji alternative
Enver Isufi	Hortikulture	Trajner
Arben Mehmeti	Hortikulture	Trajner për IPM
Advije Gashi	Organizimi i fermerëve	Trajnere
Rrustem Ilapi	Organizimi i fermerëve	Antare i komitetit drejtues te organizimit te fermerëve
Hamez Rama	Organizimi i fermerëve	Anëtare i komitetit drejtues te organizimit te fermerëve
Naim Krasniqi	Organizimi i fermerëve	Anëtare i komitetit drejtues te organizimit te fermerëve
Fatos Krasniqi	Organizimi i fermerëve	Anëtare i komitetit drejtues te organizimit te fermerëve
Pakize Kastrati	Organizimi i fermerëve	Anëtare i komitetit drejtues te organizimit te fermerëve
Dukagjin Kastrati	Administratë	Inxhinier i ndërtimtarisë
Nexhat Merovci	Administratë	Inxhinier i ndërtimtarisë
Veton Maloku	Administratë	Inxhinier i ndërtimtarisë
Blerina Halilaj	Përpunimi i ushqimit	Promotore e produkteve
Arbenita Osmani	Administratë	Përkthyes
Emina Hyseni	Administratë	Përkthyes
Radovan Jovanovic	Administratë	Përkthyes
Veton Galica	Administratë	Përkthyes
Lavdim Neziri	Administratë	Përkthyes

Praktikantet gjatë vitit 2012

Emri&Mbiemri	Departamenti	Pozita
Luarza Muhadri	Hortikulture	Praktikante
Adelina Morina	Hortikulture	Praktikante
Kreshnik Xhaferi	Hortikulture	Praktikant
Agron Bunjaku	Hortikulture	Praktikant
Bujar Ahmeti	Administratë	Praktikant
Xhavit Merovci	Blegtori	Praktikant
Indrit Ioshi	Përpunim i ushqimit	Praktikant

Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org



Adresa:
Rr Ulqini nr. 74
40000 Mitrovicë
Kosovë/a

*Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!
Let us live from our land and work!*

E-mail: info@iadk.org
Tel/Fax: +381 (0) 28 536 726
Web: www.iadk.org